



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 8877/2022
Data: 20.10.2022

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e nëntë -IX- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.08.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Bajrush Laçi** (Shef i Zyrës Ligjore), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim). Kryesuesi i Mbledhje pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Buxheti i komunës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2024-2025.
3. Kërkesë për rialokim të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale.
4. Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2023.
5. Miratimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2023.
6. Shqyrtimi i draft rregullores për administrimin e shtëpisë së kulturës në komunën e Hanit të Hanit të Elezit.
7. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:-përveç këtyre pikave të rendit të punës ndërkohë kemi pranuar vendimin nga KQZ-ja për zëvendësimin e anëtarit të ri z.Erblin Maliqi i cili e zëvendëson z.Veton Ballzhi, propozoj që të hynë në rend të punës Betimi i anëtarit të ri të kuvendit të komunës z. Erblin Maliqi për pika e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rendit të punës:

1. **Betimi i anëtarit të ri të kuvendit të komunës z.Erblin Maliqi.**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
3. **Buxheti i komunës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2024-2025.**
4. **Kërkesë për rialokim të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale.**
5. **Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2023.**
6. **Miratimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2023.**
7. **Shqyrtimi i draft rregullores për administrimin e shtëpisë së kulturës në komunën e Hanit të Elezit.**
8. **Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023.**
9. **Të ndryshme.**

1. Betimi i anëtarit të ri të kuvendit të komunës z.Erblin Maliqi.

Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvendit të komunës së Hanit të Elezit , në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

3. Buxheti i komunës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2024-2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- në bazë të qarkoreve buxhetore të cilat i kemi pranuar nga ministria e Financave lartësia e buxhetit komunal do të jetë 3 349 714.00 € . Ky buxhet është ndarë në këto kategori , në paga dhe shtesa në shumë prej 1,702,823 €, mallra dhe shërbime në shumë prej 465,000 €, Shpenzimet komunale në shumë prej 96,500 €, Subvencione dhe Transfere në shumë prej 100,000 € Shpenzimet kapitale në shumë prej 985,392 €. Janë mbajtur dëgjimet buxhetore me qytetarët dhe kemi pranuar propozimet e qytetarëve dhe shumica prej tyre kanë qenë pjesë e projekteve të cilat ishin të planifikuara , ndërsa një pjesë e propozimeve janë që bëjnë pjesë në kategorinë mallra dhe shërbime . Materialin e kemi pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

Zaim Bela thekson:- te drejtorja e bujqësisë nuk është bërë rritja e subvencioneve por ka mbetur njëjtë dhe a ekziston mundësia me u rritë subvencionet në bujqësi.

Lindita Ballazhi thekson:- shuma e mjeteve financiare në vlerë prej 100 000 € e kategorisë së subvencioneve janë të planifikuara te zyra e kryetarit të komunës, te drejtorja e bujqësisë dhe te drejtorja e arsimit. Për vitin 2023 nuk kemi mundësi me i rritur subvencionet në bujqësi.

Sherif Berisha thekson:- te administrata dhe personeli janë tri kode dhe është mirë të na jepni sqarime për mjetet financiare që janë të planifikuara .

Lindita Ballazhi thekson:- ekzistojnë tre administrata dhe atë komunale, shëndetësisë dhe e arsimit, mirëpo të gjitha këto administrata kanë kode të tjera duke filluar prej programit dhe nënprogramit .

Procedojmë me këtë rendit të punës:

1. **Betimi i anëtarit të ri të kuvendit të komunës z.Erblin Maliqi.**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
3. **Buxheti i komunës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2024-2025.**
4. **Kërkesë për rialokim të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale.**
5. **Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2023.**
6. **Miratimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2023.**
7. **Shqyrtimi i draft rregullores për administrimin e shtëpisë së kulturës në komunën e Hanit të Hanit të Elezit.**
8. **Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023.**
9. **Të ndryshme.**

1. Betimi i anëtarit të ri të kuvendit të komunës z.Erblin Maliqi.

Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvendit të komunës së Hanit të Elezit , në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

3. Buxheti i komunës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2024-2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- në bazë të qarkoreve buxhetore të cilat i kemi pranuar nga ministria e Financave lartësia e buxhetit komunal do të jetë 3 349 714.00 € . Ky buxhet është ndarë në këto kategori , në paga dhe shtesa në shumë prej 1,702,823 €, mallra dhe shërbime në shumë prej 465,000 €, Shpenzimet komunale në shumë prej 96,500 €, Subvencione dhe Transfere në shumë prej 100,000 € Shpenzimet kapitale në shumë prej 985,392 €. Janë mbajtur dëgjimet buxhetore me qytetarët dhe kemi pranuar propozimet e qytetarëve dhe shumica prej tyre kanë qenë pjesë e projekteve të cilat ishin të planifikuara , ndërsa një pjesë e propozimeve janë që bëjnë pjesë në kategorinë mallra dhe shërbime . Materialin e kemi pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

Zaim Bela thekson:- te drejtorja e bujqësisë nuk është bërë rritja e subvencioneve por ka mbetur njëjtë dhe a ekziston mundësia me u rritë subvencionet në bujqësi.

Lindita Ballazhi thekson:- shuma e mjeteve financiare në vlerë prej 100 000 € e kategorisë së subvencioneve janë të planifikuara te zyra e kryetarit të komunës, te drejtorja e bujqësisë dhe te drejtorja e arsimit. Për vitin 2023 nuk kemi mundësi me i rritur subvencionet në bujqësi.

Sherif Berisha thekson:- te administrata dhe personeli janë tri kode dhe është mirë të na jepni sqarime për mjetet financiare që janë të planifikuara .

Lindita Ballazhi thekson:- ekzistojnë tre administrata dhe atë komunale, shëndetësisë dhe e arsimit, mirëpo të gjitha këto administrata kanë kode të tjera duke filluar prej programit dhe nënprogramit .

Mehmet Ballazhi thekson:- buxhetin të cilin ne e kemi propozuar për miratim në kuvendin e komunës është në interes të qytetarëve se jemi bazuar në kërkesat të cilat qytetarët janë përcaktuar më shumë. Grantet qeveritare janë të planifikuara prej nivelit qendrorë ndërsa komuna vetëm e bënë ndarjen . U sugjerua që të rriten subvencionet në bujqësi por duhet të shikohen mundësit se a mundemi sepse ashtu janë të planifikuara . Të hyrat vetanake janë të planifikuara nga qeveria që na me i inkasuar ato mjete financiare. Grandi arsimit dhe shëndetësisë e ka buxhetin e veçanta dhe nuk mundemi me ndërhyrë dhe ju e dini që shpesh herë kemi me shtypin e kulturës për shkak se nuk na lejohet me pranuar punëtorë dhe Ministria ka investuar, mirëpo gabimi ka qenë i më hershëm sepse nëse ndërtohet një shtëpi e kulturës apo çfarëdo institucioni duhet të dihet numri i punëtorëve sepse duhet të mirëmbahet.

Sherif Berisha thekson:- unë mendoj që duhet të specifikohen sepse duhet të dihet sa shpenzohet letër për një vit e jo vetëm me shënuar mallra dhe shërbime por duhet të potencohet konkretisht se çka shpenzohet.

Lindita Ballazhi thekson:- tabelat ju që po i kërkon dërgohen në Ministri dhe në kuvend dorëzohen si total dhe në raportet financiare që do të paraqiten shënohen me kode ekonomike se ku janë shpenzuar ato mjete financiare, ndërsa në projekt buxhet dorëzohen vetëm totalët . Te kategoria mallra dhe shërbime kemi shumë kategori dhe shumë kode ekonomike .

Refet Kalisi thekson:- shuma e mjeteve financiare të të hyrat veanake në vlerë prej 500 000.00 € është shumë e madhe dhe e vështirë për me u realizuar. Ndërtimi i rrjetit elektrik në fshatin Pustenic mendojë që janë ndarë pak mjete 15000 € por mendoj që duhet me i shtuar mjetet për me u bërë një punë më e mirë. Ndriçimi publik Pustenic, Dimcë, Goranc, Krivenik, Seqishtë mendoj që më mirë është të potencohet ndërrimi i poqeve elektrike për shkak se ndriçim publik kemi por poqat i kemi të thjeshtë dhe është mirë të rritet dhe të bëhen poqat lled. Është paraparë renovimi i objektit të komunës , kërkoj sqarim se çka mendohet këtu mu bërë . Ndërtimi i mbikalimit në rrugën “Martirët Bushi” dhe rruga Lepenci në shumë prej 7000 € . Rregullimi i infrastrukturës dhe ndërtimi i aneksit në QKMF .

Lindita Ballazhi thekson:- planifikimi i të hyrave vetanake është përcaktuar nga Ministria në bazë të trendit të rritjes. Vazhdimisht kemi bërë kërkesë për zvogëlimin e të hyrave vetanake.

Mehmet Ballazhi thekson:- sa i përket të hyrave për afërsisht borxhe të trashëguara janë afër një milion dhe problemin e kemi se si me pastruar këtë listë të borxheve . Te rrjeti elektrik në fshatin Pustenic nuk është shumë e mjaftueshme për me kryer atë projekt por është projekt i ri dhe jemi munduar që të jetë në kuadër të projekteve për shkak se këto janë mundësit . Kur isha anëtarë i kuvendit të komunës për rritje të kapaciteteve të ujit mjete të ndara ishin njëmijë euro që mendoj se ka qenë qesharake dhe për atë kam dedikuar më shumë mjete që së paku projektin me hartuar. Ndriçimi publik është projekt dhe nëse bëhet edhe ndërrimi i poqeve mbetet pa u rregulluar ndriçimi publik nga hekurudha dhe në përgjithësi është si projekt. Renovimi i objektit të komunës nuk është projekt i ri dhe nëse parashihet me një moment të caktuar me u rregulluar diçka si kategori buxhetore e kemi. Projektin e mbikalimit të çerdhja e kemi planifikuar por nuk e dimë a realizohet për shkak se aty ka prona të cilat duhet të shpronësohen dhe e kam parapri për shkak se duhet të zhbllokohet komunikacioni dhe për atë e kemi paraparë rruga Lepenci. Është paraparë ndërtimi i parkut te rruga Lepenci që do të hynë në kuadër të shtratit të lumit Lepenc.

Refet Kalisi thekson:-nuk jam kundër këtyre projekteve por shpresoj që është fat dhe realizohen për shkak se çdo projekt i ka të mirat e veta.

Sherif Berisha thekson:- te shtimi i kapaciteteve të ujit është paraparë një shumë prej 25 000 € për vitin 2023 dhe kjo shumë është e vogël dhe besoj që e keni vërejt që sasia e ujit është shumë e vogël , po ashtu e vërejt që është një neglizhim apo e njëjta po vazhdon sikur më herët për shkak se është shumë e vogël. Janë duke u vendosur orëmatësit por ujë nuk ka dhe nuk di si është menduar kjo çështje . Projekti rregullimi i parkut në rrugën “Isa Berisha” , asfaltim , trotuari, ndriçimi publik dhe ndriçimi por rregullimi i këtij projekti ka filluar dhe janë planifikuar 20000 € për vitin 2023 . Projekti i gjelbërimit të disa hapësirave publike për rreth objektit të komunës dhe në Han të Elezit , mirëpo është mirë të na sqarohet për rreth komunës ku ka hapësirë që duhet të gjelbërohet . Keni ndarë mjetë financiare për shkollë dhe nuk jam kundër kësaj por është mirë që të analizohet dhe të bisedohet sepse të gjithë e dimë që në atë pjesë nuk kemi hapësirë për një shkollë. Është mirë të mendohet për ndërtimin e shkollës në Lagje të Re se e dimë që shkolla në fshatin Rezhancë dhe Krivenik është mbyllur. Sa i përket shkollës kam propozim konkretë që të hynë në kuadër të projekteve ndërtimi edhe i një aneksi të shkollës te “Ilaz Thaqi” . Te Ura e Seçishtës është paraparë një aneks shtesë dhe është dashur të planifikohet edhe te Ura e Fezës . Rregullimi i infrastrukturë dhe aneksit të QKMF-së por është mirë të bëhet parkingu për shkak se automjetet parkohen në trotuar. Rregullimi i oborrit të AMF-së në fshatin Gorancë unë mendoj që duhet t’i kushtohet rëndësi mirëmbajtjes. Për vitin 2023 kërkoj që të hynë si projekt rruga transit në fshatin Gorancë .

Nora Xhoni thekson:- pse nuk është projekti për banim social dhe është mirë ta arsyetoni se pse nuk është përfshi ky projekt.

Mehmet Ballazhi thekson:- çështjen e banimit social e kemi diskutuar por as mundësitë më të vogla nuk i kemi për shkak të mungesës së hapësirave . Sa i përket shkollës në Lagje nuk kemi hapuri dhe vetë qytetarët e kanë formuar iniciativën zhvillimore e cila është e certifikuar nga Ministria e Punëve të Brendshme me dokumentacionin përcjellës . Ne e kemi përkrahur si iniciativë idenë për ndërtimin e shkollës në Lagje të Re për arsye se zhvillimi i një qyteti zhvillohet njëjtë në gjitha rajonet sepse katër dhjetë përçin e qytetarëve e frekuentojnë qytetin nga ajo pjesë dhe 456 nxënës frekuentojnë prej asaj ane të cilët e vijnë në mësimin . Nëse mendojmë që me një të ardhme për mësimin gjithë ditorë duhet të ecim me botën . Ne e kemi mbyllur shkollën në fshatin Krivenik pavarësisht disa kundërshtime të disa banorëve, mirëpo nuk mundemi me bërë veprime politike për shkak se nëse shkolla në Krivenik mbetet me funksionuar duhet të me lënë vetëm për arsye politike por unë nuk e bëj. Neve na duhet cilësia në arsim e jo objekti shkollorë. Në takimin të cilin e kam pasur me Ministren e Arsimit ka kërkuar që të sigurohet lokacioni ndërsa Ministria do ta financon ndërtimin e shkollës por ne duhet ta marrim këtë iniciativë së bashku dhe ta mbështesim dhe si udhëheqës dhe përfaqësues të qytetarëve duhet të mendojmë për një të ardhme e mos të bëjmë politika ditore. Nëse është shkatërruar parku i AMF-së duhet të rregullohet. Punimet të cilat parashihen me u bërë te QKMF-ja parashihet edhe parkingu me u rregulluar . Projektin e rrugës transit në fshatin Gorancë nuk e kemi paraparë sepse nuk kemi mundësi financiare sepse planifikimet buxhetore i kemi bërë për ato projekte të mundshme për me i realizuar.

Sherif Berisha thekson:- nuk kam diçka kundër projektit në lagje por realizimi mund të zgjatë me vite dhe për atë kërkoj që të bëhet aneksi i shkollës . Për atë pjesë ku po flasim mund të ketë probleme te parcela , te mjetet financiare po mos të jetë pengesë aneksi sepse mund të realizohet dhe bëhet një ndërrim shkolla “Ilaz Thaqi”. Te rruga e transitit është mirë me bërë diçka për shkak se fëmijët e fshatit Gorancë janë të rrezikuar . Te projekti për rreth objektit të komunës dhe te parku “Isa Berisha” kërkoj sqarim.

Mehmet Ballazhi thekson:- hapësira të gjelbëruara nuk janë projekte që mund të kryhen gjatë periudhës së realizimit të projektit . Ju e dini që i kemi tre bunker dhe nuk po dum me i prish për shkak rëndësisë historike që e kanë sepse duhet të arsyetoni para dikujt se pse ja kemi lënë emrin parkut të qytetit “Isa Berisha “ dhe vitin tjetër duhet të rregullohen edhe bunkerët. Sa i përket çështjes së shkollës e kemi bërë analizë e kemi diskutuar dhe e kemi marr mendimin e shumicës dhe është më se e nevojshme . E kemi diskutuar edhe aneksin e shkollës mirëpo shumë më e nevojshme është ajo pjesë për shkak të perspektivës sepse nuk e kemi një institucion publik por vetëm një Xhami. Ndërtimi i shkollës në atë parcelë ka më shumë siguri se sa aneksin të cilin po e propozon.

Kryesuesi thekson:- kryetari dha arsyet e veta sa i përket çështjes së ndërtimit të shkollës dhe për çështjen e propozimit të z.Sherif Berisha kërkoj që të kemi pesë minuta pushim. Pas konsultimeve që patëm me shefat hapi diskutimin.

Refet Kalisi thekson:- projektin për rrymën nëntokësore ka qenë i planifikuar për vitin 2023 por nuk është përfshirë në këtë projekt buxhet. Është iniciativë e mirë që është marr për ndërtimin e shkollës por është dashur me ndarë mjete financiare për shpronësim.

Mehmet Ballazhi thekson:- nëse një projekt nuk realizohet për një kohë të gjatë hiqet nga Ministritë e linjeve. Sa i përket ndarjes së mjeteve për shpronësim nuk i kemi mundësitë dhe besojë këto mjete financiare do të mbliidhen nga qytetarët.

Lindita Ballazhi thekson:- gjatë dëgjimeve buxhetore të cilat i kemi pasur kemi pranuar shumë propozime prej qytetarëve e që shumica prej tyre janë të planifikuara në projekt buxhet. Në listën e propozimeve të cilën e kam përcjell kam dhënë arsyeshmërinë e secilit propozim dhe kërkoj që të miratohet lista e propozimeve me arsyetime të cilën e kam dhënë .

Kryesuesi thekson:- propozimin e z. Sherif Berisha e hedh në votim ; rezultati i votimit ishte 7 për , 7 kundër , 1 abstenim që do të thotë nuk kalon propozimi. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 14 për 1 kundër (nga grupi parlamentar i LVV-së) .

U MIRATUA BUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN 2023 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITIN 2024-2025

4. Kërkesë për rialokim të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Zaim Bela thekson:- këto kanë qenë si kode dhe këto mjete do të grumbullohen me një projekt dhe është mirë me naj sqaruar se në cilin projekt dedikohen.

Sherif Berisha thekson:- rialokimi i këtyre mjeteve është prej të njëjtit kod dhe përshkrimi është i njëjtë por vetëm shuma e mjeteve financiare dallon .

Lindita Ballazhi thekson:- në materialin të cilin e kam përcjell e kam sqaruar se i kemi shtatë projekte që mjetet e tyre riallokohen në projektet të cilat i kam potencuar më poshtë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KËRKESA PËR RILOKIM TË MJETEVE NË KATEGORINË E SHPENZIMEVE KAPITALE

5. Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- komisioni i cili është formuar prej kuvendit të komunës ka përgatitur planin dhe e ka përcjell për komitet për politikë e financa. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Refet Kalisi thekson:- propozoj që të hyn në plan të punës rregullorja për mirëmbajtje të varrezave.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

6. Miratimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Majlinda Kaloshi thekson:- rregullorja është shqyrtuar në komitet për politik e financa dhe në kuvendin e komunës dhe sot vetëm kemi miratimin e kësaj rregullore. Gjatë procedurave që ka kaluar kemi vërejtur që nuk e kemi përfshirë taksën për laboratorët e analizave andaj kemi propozuar që kjo taksë të jetë 100 €

Refet Kalisi thekson:- te gurëthyesit propozime nga qytetarët ka që për me ju ngritur taksa por propozimi që është dhënë më duket se është shumë por unë nuk jam për me ngritur dhe bizneset jam për me i lehtësuar sa më shumë. Shpedicionet taksën vjetore për ushtrim të veprimtarisë e kanë 100€ dhe kanë kërkuar që kjo taksë me u zbritur në 50€ por unë do ta përkrahin propozim e ekzekutivit.

Mehmet Ballazhi thekson:- në material e keni rregulloren që janë dhënë propozimet nga drejtoritë dhe pastaj ju kemi përcjell edhe propozimet e qytetarëve . Taksa e shpedicioneve nuk është shumë por pasi ata i kishin disa politika të vetat për shkak të numrit të punëtorëve të cilët punojnë aty ne kemi menduar që taksën vjetore nga 100 € me u a zbritur në 80 € . Edhe për disa kategori tjera ka pasur propozime që me i ngritur taksat por propozimi duhet të jetë i arsyeshëm.

Nora Xhoni thekson:- sa përket taksës për frizeret unë mendoj që këta kanë punë sezonale. Unë mendoj që edhe bukëpjekësve mos me ju ngritur taksa për shkak se çmimet janë ngritur në të gjitha sektorët .

Kryesuesi thekson:- propozimin e kryetarit të komunës për taksën e shpedicioneve e hedh në votim , rezultati i votimit ishte njëzëri. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RREGULLORJA PËR TAKSA KOMUNALE PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK

7. Shqyrtimi i draft rregullores për administrimin e shtëpisë së kulturës në komunën e Hanit të Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë me shtuar nuk kam. Nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni.

Resul Suma thekson:- a ka me pasur staf tjetër në shtëpinë e kulturës përveç drejtorit.

Sherif Berisha thekson:- këto të cilat janë shënuar në letër kërkoj që në të ardhmen të zbatohen .

Hisni Luri thekson:-kërkesë kemi parashtruar në Ministri për një menaxher, zyrtarë për rini, zyrtarë për sport , shtëpiak, punëtorë teknik, zyrtarë për depo, roje. Të gjitha këto kërkesa i kemi parashtruar për shkak se objekti i qendrës kulturore ka hapësirë shumë të madhe . Rregullorja po shpresoj që në të ardhmen do të zbatohet.

Hanumshahe Dibrani thekson:- a ka mirëmbajtës te shtëpia e kulturës.

Hisni Luri thekson:- aktualisht i kemi vetëm dy zyrtarë.

Refet Kalisi thekson:-është mirë që ta mirëmbajmë shtëpinë e kulturës për shkak se ishin disa defekte te banjot.

Hisni Luri thekson:-furnizimi kryesorë i ujit bëhet me një presion të madhe dhe po shkakton defekte por do të mundohemi me gjet një instrument që e redukton dhe besoj që do të rregullohet.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA DRAFT RREGULLORJA PËR ADMINISTRIMIN E SHITËPISË SË KULTURËS NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK

8. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson:- në material i keni të gjitha informacionet në detale, nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të shtoni.

Hyriete Isufi thekson:- si do të jetë roli i psikologut nëpër shkolla.

Hisni Luri thekson:- varet prej nevojave si do të jenë por do t'i viziton brenda javës të gjitha shkollat.

Resul Suma thekson:- në informatë shënon se është mbyllur paralelja shkollore në fshatin Krivenik dhe është mirë që është mbyllur për shkak se duhet të ketë cilësi në arsim , mirëpo është mirë me bashkëpunuar me prind që fëmijët me pasur vijueshmëri të mirë në shkollën e fshatit Seçishtë

Hisni Luri thekson:- çështjes së transportit do t'i qëndroj mbrapa dhe prindërit i kemi njoftuar dhe nëse kanë ndonjë ankesë për transportin unë do të mundohem me zgjidhur. Unë mendoj se më mirë do ta kenë tash se kanë me dalur nga dera shtëpisë dhe kanë me hipur në kombi bus se sa prej shtëpisë e deri te shkolla ku kanë mësuar. Komuna për këtë rast ka shpenzime më shumë por jemi duke e bërë për hir të atyre nxënësve e për askënd tjetër.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Xhevahir Dernjani thekson:- vërejtje kam për kompaninë “Elektra” afër një muaj janë duken i kryer punimet por qytetarët nuk kanë rrejt edhe pse qytetarët i kanë kryer pagesat. Është mirë që drejtorja e shërbimeve publike me kontaktuar me kompaninë dhe me shprehur ankesat e qytetarëve. Ankesë kam për çështjen e dritave te lagja te kufiri për shkak se nuk janë funksionale.

Sherif Berisha thekson:- është pranuar një mjeke me kontratë në vepër mirëpo pozita e mjekut është e lirë ndërsa pranohen mjekë me kontratë me kohë të caktuar. Në QKMF i kemi dy laborantë me kontratë a mendoni që veproni mirë që gjatë kohës së pushimit të njërit laborantë tjetri nuk kryen shërbime apo duhet të shkohet nëpër laboratore private. Cili ligj e përcakton që rastet emergjente transponohen me nivel dytësorë apo tretësorë vetëm me një praktikante pa prezencën e mjekut apo infermierit për shkak se transporti në këtë mënyrë e rrezikon pacientin sepse me një praktikante nuk keni të drejtë ta transportoni pacientin për shkak se nëse ndodhë ndonjë rast kush do të jep përgjegjësi. E njëjta situatë është në AMF-në e fshatit Gorancë që shërbimet në këtë qendër shëndetësor po i japin praktikantët pa prezencën e mjekut apo infermierit. Kërkoj të më sigurohet vendimi i ushtrueses së detyrës në QKMF mbi vazhdimin e mandatit. Te drejtorja e arsimit kërkoj listën e të punësuarve në çerdhe . A keni rregullore të brendshme të punë në çerdhe. Drejtorja për shërbime publike të më jep një raport me shkrim rreth zhvillimeve të punimeve të ujësjellësit.

Hanumshahe Dibrani thekson:-kërkoj informacion për tre infermieret të cilat u pranuar dhe u anulua konkursi dhe ku kanë mbetur procedurat. Në takimet të cilat i keni pasur me organizatën "Islamik Relief" a kanë premtuar se do të ndihmojnë diçka në shëndetësi.

Zaim Bela thekson:- kontinierët të cilët janë hequr është mirë me na informuar se ku janë dërguar. dëgjova që sipërfaqja e Hanit të Elezit është mbi 50 % e mbuluar me pyje dhe një drejtorë i drejtorisë së bujqësisë punon në dy vende të punës por është një rregullore të pylltarët që duhen të jenë të gatshëm njëzet e katër orë për shkak se mund të ndodhë ndonjë zjarr apo prerje ilegale. Kemi pasur mbledhje të komitetit për komunitete dhe vërejtje është dhënë nga anëtarët e komitetit për komunitet për shkak se asnjë drejtor nuk ka marr pjesë në mbledhje. Po ashtu është diskutuar dhe është kërkuar që drejtoria e arsimit të angazhohet për shkak se në fshatin Dimcë janë disa shpella dhe flitet që ka qenë edhe kisha dhe drejtoria nëse shpreh gatishmërinë me dal me vizituar.

Resul Suma thekson:- ankesa kam nga banorët e Lagjes Bela për shkak se është shpërthyer një kanalizim dhe po kundërmon erë të rëndë dhe është mirë që drejtoria për shërbime publike ta rregullon.

Mehmet Ballazhi thekson:- sa i përket trashëgimisë kulturore duhet të merremi me hulumtime por ne nuk kemi kapacitet dhe tërë punën që e kemi bërë për trashëgiminë kulturore e kemi bërë një projekt me fshatin Letnicë të cilin e kemi bërë një raport dhe ka dalur shumë i mirë. Për çështjen e kishave duhet të marrim informacione më të hollësishme sepse duke u munduar mund ti bëjmë argat dikujt tjetër dhe duke u munduar me bërë diçka mirë bëjmë keq. Kërkesa për lirin e hapësirave është kërkesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme e drejtorisë së projekteve për shkak se është paraparë me u ndërtuar stacioni i policisë. Kontinerët i kemi dërguar për rojet e pyjeve dhe për shoqatën e gjuetarëve. Sa i përket punësimit në dy vende të punës nuk kemi mundësi me ndikuar për shkak se secili mund të punon në dy apo tri vende të punës por nuk mundet në dy vende të punës me punuar në vijën buxhetore të njëjtë institucionale

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- mjekun me kontratë bë vepër e kemi angazhuar në kohën kur filloj përsëri pandemia dhe nuk ka pozita të lira të mjekut dhe asnjë pozitë nuk e kemi të lirë përveç pozitës së drejtorit të QKMF-së . Takim të vazhdueshme kam pasur me organizatën "Islamik Relief" por ende nuk kam diçka pozitive për kërkesat që ua kam dërguar për shkak se siç kanë potencuar është ndërruar bordi. Pranimin ne tre infermierëve e kam kërkuar në kohën kur më është dashur me zëvendësuar stafin prej tre infermierëve por njëra nga kandidatet që ka aplikuar është ankuar në OSHP dhe ende nuk kemi marr përgjigje.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:36

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

